



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Shtator 2015

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Tetor 2015

Nëntor 2015

Dhjetor 2015

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Shtator 2015

© Ministria e Financave, 2015

Drejtoria e Makroekonomisë

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: marsed.harizi@financa.gov.al

eva.doda@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
ANEKSI STATISTIKOR	13


Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin shtator 2015 arriti në 118.91 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin shtator 2015 ishte 2.3 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin shtator 2015 ishte 124.19 lekë për dollarë dhe 139.52 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit shtator 2015 shënuan kuotat 1.27 për ato 12-mujore, 1.01 për 6-mujoret ,0.69 për qind për depozitat 3-mujore dhe 1.35 për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 8.50 për qind për huatë 12-mujore dhe 8.11 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 1'198'897.8 milionë lekë në muajin shtator, duke shënuar një rritje prej rreth 2.8 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për tremujorin e tretë të 2015-ës rezultoi me një suficit të bilancit të përgjithshëm prej 314.3 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar-shtator 2015 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 19 miliardë lekë, që do të thotë se rreth 28% më pak se planifikimi progresiv mujor (ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 26.2 miliardë lekë).
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-shtator 2015*, arritën në rreth 279.5 miliardë lekë, ose afërsisht 97.8 për qind e planit për muajin.
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë*, arritën në rreth 298.5 miliardë lekë, ose 95.6 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin shtator 2015 pësoi rritje prej 0.6 për qind krahasuar me muajin gusht 2015, kur ky indeks shënonte rritje prej 0.8 për qind, krahasuar me muajin paraardhës. Gjatë muajit korrik 2015, ky indeks shënoi rënie me -0.7 për qind krahasuar me muajin qershor 2015. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti më parë kanë shënuar rritje me 0.3 për qind, rritje me 0.1 për qind dhe rënie me -0.6 për qind.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kategoria me kontribut më të lartë në inflacionin e përgjithshëm në muajin shtator ishte “Shërbim arsimor” me një rritje vjetore të çmimit prej +10.5%, duke kontribuar me +0.1 pikë përqindje, si dhe “Pije alkoolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +6.9% duke kontribuar me +0.3 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm. Rënia më e madhe gjatë muajit shtator u konstatua në kategorinë “Transport” dhe “Qera, ujë lëndë djegëse dhe energji” me përkatësisht -2.5 dhe -2.1 për qind. Pësha specifike relativisht e ulët që zënë këto grupe në shportën e mallrave të konsumit, bën që n

ndryshimet e çmimeve për këto grupe të kenë efekte të ulëta mbi normën e inflacionit me nga -0.2 dhe -0.1 pikë përqindje.

Norma vjetore e inflacionit në muajin shtator arriti në 2.3 për qind. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitin 2014 dhe për periudhën janar-shtator 2015 paraqiten në tabelën 1.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2014	1.7	1.9	2.2	1.7	1.6	1.5
2015	1.3	2.3	2.2	2.3	1.8	1.4
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2014	1.8	2.0	1.5	1.4	1.7	0.7
2015	1.3	2.0	2.3			


Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin shtator 2015, arriti në 139.52 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me -0.05 për qind me një muaj më parë. Në fund të muajit shtator, një euro u këmbye me 139.39 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin shtator 2015, arriti në 125.19 lekë/dollarë duke shënuar rënie me -0.96 për qind kundrejt muajit gusht 2015. Në fund të muajit shtator, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 124.19 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin shtator të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 15 për qind, ndërsa kundrejt monedhës europiane rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar në masën -0.3 për qind. Nënçmimi i lekut kundrejt monedhës europiane dhe mbiçimi kundrejt monedhës amerikane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të Euros me Dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare duke arritur në rreth 0.9 dollarë/euro.

Fig-2



Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit shtator 2015


Burimi: Banka e Shqipërisë

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit shtator 2015, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 1.27 për qind, duke shënuar rritje me 0.23 pikë përqindje krahasuar me muajin gusht 2015. Rënie për këtë muaj ka shënuar norma e interesit të depozitave me afat të maturimit 6 dhe 3-mujor duke arritur respektivisht në nivelin 1.01 dhe 0.69, duke shënuar ulje prej -0.13 dhe -0.03 pikë përqindje. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 12, 6 dhe 3-mujore ku rënia më e madhe prej 0.48 pikë përqindje është shënuar nga depozitat me afat të maturimit 1 muajor që kanë arritur nivelin 1.38 për qind.

Fig-3




Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit shtator shënoi rritje me 0.9 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 8.50 për qind krahasuar me muajin gusht 2015. Norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi rënie me -0.17 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin shtator arriti në 8.11 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, norma e interesit të huave me afat maturimi 12-mujor ka shënuar rritje me 0.94 pikë përqindje, ndërsa ato me afat maturimi 6-mujor kanë pësuar rënie me 1.27 pikë përqindje.

Fig-4




Normat e interesit për huatë dhe bonot (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë


Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit shtator 2015, për bonot 12, 6 dhe 3-mujore ishin përkatësisht 3.21, 2.87 dhe 2.61 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rënie në *yield*-in e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12, 6 dhe 3-mujore përkatësisht me 0.01, 0.03 dhe 0.05 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë.

4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave për tremujorin e tretë të 2015 regjistroi një tepricë të bilancit të përgjithshëm prej 314.3 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në figurën 5. “Llogaria kapitale dhe financiare” për tremujorin e tretë të 2015 rezultoi të jetë me një deficit prej -378.1 milionë euro.




Kompozicioni i llogarisë korrente prej -325.6 milionë euro, është shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për vitin 2015: (i) bilanci tregtar me -608.4 milionë euro, (ii) shërbime neto me 133.8 milionë euro, (iii) të ardhura netome -23.1 milionë euro, (iv) transferta neto me 172.1 milionë euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit shtator 2015, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 83,024 miliardë lekë krahasuar me muajin shtator të vitit 2014. Kjo rritje ka ardhur më së shumti si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 51,604.8 miliardë lekë dhe të bankave të nivelit të dytë me rreth 31,419.2 miliardë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto.



Në muajin shtator 2015, sistemi bankar rezulton me një rritje prej 2,161.0 miliardë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin gusht 2015. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë.




6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin shtator 2015 arriti në 546'300.3 miliardë lekë. Teprica së kredisë, krahasuar me shtator 2014 shënoi rënie me vlerë -9'972 miliardë lekë, pra rënie prej rreth -1.8 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 56.2 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 306,853 milionë lekë.

Gjatë muajit shtator 2015, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 65.3 për qind ose 356,554 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 28.24 për qind ose 154,280 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.83 dhe 1.50 për qind apo 26,370 dhe 8,207 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin shtator 2015, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 54.28 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 34.35 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.84 për qind dhe rreth 23.47 për qind.


Fig-9



Rritja e stokut total të kredive

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-10




Përberja e kredive Shtator '15

Burimi: Banka e Shqipërisë

7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin shtator 2015 shënoi rënie prej -0.4 për qind krahasuar me muajin paraardhës gusht 2015. Kjo ofertë arriti në rreth 1,198,897.8 milionë lekë në fund të muajit shtator 2015, duke shënuar një rritje vjetore kundrejt nivelit të regjistruar në muajin shtator 2014 prej 2.8 për qind.

Fig-11




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin shtator 2015, kanë pësuar rënie prej 2,411 milionë lekë në krahasim me muajin shtator 2014. Depozitat në valutë gjatë muajit shtator 2015 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 85.2 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë, sektori i individëve ka zënë rreth 87.5 për qind të tyre.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit shtator 2015, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 87.5 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 9.5 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 2 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 85.2 për qind dhe rreth 12.6 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 86.3 për qind e totalit (në lekë).

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 973,942.8 milionë lekë) të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (107,827.8 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (15,135 milionë lekë) dhe “Korporata të tjera financiare” (8,342.4 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1,870.4 milionë lekë në totalin e depozitave.

Fig-14



Përberja e depozitave Shtator 2015

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit shtator 2015, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave shënoi një rënie prej -1,746.8 milionë lekë, kjo si rezultat i rritjes së depozitave në valutë me rreth 278.4 milionë dhe të depozitave në lekë me rreth 2,025.2 milionë lekë.

Sektori Fiskal


1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-shtator 2015 janë mbledhur rreth 279.5 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 298.5 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 249.5 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 34 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 56% janë financim i brendshëm.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 97.8% të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 95.6% të këtij plani. Shpenzimet korrente janë rreth 97% e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 88.5% të tij.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 190.1 miliardë lekë (ose rreth 97.8% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 9.4 miliardë lekë (ose rreth 101.4% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 52.7 miliardë lekë (ose rreth 100.5% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 20.9 miliardë lekë (ose rreth 93.1% e planit të periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 249.5 miliardë lekë, 53.2 miliardë lekë (21% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 27.2 miliardë lekë (11%) për interesat, 27.3 miliardë lekë (11%) për shpenzime



operative dhe mirëmbajtje, 1.2 miliardë lekë (0.5%) për subvencione, 102.8 miliardë lekë (41%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 23.2 miliardë lekë (9.3%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 14.4 miliardë lekë (5.8%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 71% (shpenzime personeli), 67% (shpenzime për interesat), 66% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 70% (subvencione), 72% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 58% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe 59% shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 54%, ndërsa financimi i huaj është 49% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-shtator 2015 ishin rreth 279.5 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 252.4 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 20.9 miliardë lekë.

Tab - 2 Të ardhurat gjatë periudhës janar-shtator 2015 (mld Lekë)

Burimi	sht'15	sht'14	Ndryshimi në (%)
TVSH (VAT)	90.8	91.9	-1.2
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	18.3	16.1	13.7
Taksa doganore (Custom Tax)	4.19	4.21	-0.5
Taksat nacionale (National Tax)	25.3	24.6	2.8
Akcizat (Excise)	29.5	29.3	0.7
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	21.9	20.5	6.8

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: shtator – 2015;

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: September – 2015;

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 19 miliardë lekë, për periudhën janar-shtator 2015, u mbështet nga huamarrja e brendshme si mjeti kryesor i financimit të brendshëm (rreth 137% të totalit të deficitit), dhe nëpërmjet huasë afat-gjatë të huaj (rreth 47% të totalit të deficitit).

Për muajin shtator 2015, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 31,007 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 33,774 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin shtator 2015, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 28.7 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 27.7 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 5.4 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1		Indeksi i Çmimeve të Konsumit Consumer Price Index																	
Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2010	2011	2012	2013	2014	2015	
Janar	0.9	0.8	0.7	1.0	0.8	1.4	1.00	0.80	0.71	1.00	0.80	1.4	3.6	3.3	1.6	2.7	1.7	1.3	January
Shkurt	1.1	2.3	1.3	1.1	1.4	2.4	1.02	1.55	1.01	1.05	1.10	1.9	4.7	4.5	0.6	2.5	1.9	2.3	February
Mars	0.1	-0.1	0.4	0.2	0.5	0.4	0.71	1.00	0.80	0.77	0.90	1.4	4.1	4.3	1.0	2.4	2.2	2.2	March
Prill	-0.4	-0.6	-0.1	-0.1	-0.6	-0.5	0.42	0.60	0.58	0.55	0.53	0.9	3.7	4.1	1.6	2.3	1.7	2.3	April
Maj	-1.2	-1.1	-0.8	-1.0	-1.1	-1.6	0.10	0.26	0.32	0.24	0.20	0.4	3.3	4.2	1.9	2.1	1.6	1.8	May
Qershor	-0.7	-1.1	-0.8	-0.6	-0.7	-1.1	-0.04	0.04	0.12	0.15	0.05	0.1	3.2	3.9	2.2	2.3	1.5	1.4	June
Korrik	-0.5	-0.7	-0.2	-0.8	-0.6	-0.7	-0.10	-0.07	0.08	-0.03	-0.04	0.2	3.4	3.6	2.7	1.6	1.8	1.3	July
Gusht	0.8	0.3	0.4	-0.1	0.1	0.8	0.01	-0.02	0.12	-0.04	-0.03	0.1	3.5	3.1	2.8	1.2	2.0	2.0	August
Shtator	0.7	0.4	0.2	0.8	0.3	0.6	0.09	0.02	0.13	0.06	0.01	0.2	3.4	2.8	2.6	1.7	1.5	2.3	September
Tetor	0.2	0.4	0.2	0.1	0.1		0.10	0.06	0.14	0.05	0.02		3.0	3.0	2.4	1.7	1.4		October
Nëntor	0.2	0.1	0.2	-0.5	-0.2		0.11	0.06	0.14	0.01	0.00		2.8	2.9	2.5	1.0	1.7		November
Dhjetor	2.2	1.0	0.9	1.7	0.7		0.28	0.14	0.20	0.15	0.06		3.4	1.7	2.4	1.9	0.7		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source: INSTAT, Bank of Albania

Tab - 2		Kursi i këmbimit Exchange rate Lekë për njësi të monedhës së huaj (Lek per unit of foreign currency)														
Monedha	2010	2011	2012	2013	2014	2015									Currency	
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator		
<i>Mesatarja e periudhës</i>																
USD	103.94	100.90	108.18	105.67	113.64	120.73	123.46	129.66	129.97	126.19	125.61	126.99	125.39	124.19	Average of period	
EURO	137.79	140.33	139.04	140.27	140.11	140.04	140.23	140.41	140.26	140.82	140.82	139.85	139.59	139.52	EURO	
<i>Fundi i periudhës</i>																
USD	104.00	107.54	105.85	101.86	115.23	123.35	124.96	130.63	125.61	128.48	125.57	127.49	124.63	124.24	USD	
EURO	138.77	138.93	139.59	140.20	140.14	139.72	140.36	140.34	140.53	140.98	140.29	139.59	139.73	139.39	EURO	

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

Tab - 3 Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)
Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2010	2011	2012	2013	2014	2015										Shtator Sep	In percent
	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht Aug									
Norma e depozitave																	Deposits rates
12-M	6.07	5.87	5.38	4.17	1.51	1.42	1.57	1.46	1.45	1.59	1.45	1.42	1.04	1.27			12-M
6-M	5.16	4.87	4.50	3.40	1.16	1.22	1.25	1.08	1.05	1.13	1.09	1.06	1.14	1.01			6-M
3-M	4.42	4.22	3.83	2.72	0.83	0.77	0.90	0.72	0.79	0.89	0.71	0.70	0.72	0.69			3-M
1-M	4.70	4.39	3.62	2.79	1.47	1.52	1.51	1.42	1.59	1.59	1.62	1.38	1.35	1.32			1-M
Norma e huasë																	Lending rates
12-M	11.52	11.17	10.28	9.52	7.00	7.76	7.36	8.74	8.14	7.98	8.85	7.62	7.60	8.50			12-M
6-M	11.69	12.28	10.61	9.59	8.18	8.21	8.17	9.30	10.18	8.86	9.28	7.49	8.28	8.11			6-M
Norma e letrave me vlerë																	Securities rates
Bono thesari 1/																	Treasury bills 1/
3-M	5.29	5.31	5.03	3.40	3.15	3.23	3.19	3.11	3.00	2.90	2.79	2.71	2.66	2.61			3-M
6-M	6.41	6.23	5.65	3.54	3.16	3.23	3.23	3.25	3.14	3.11	3.04	2.97	2.90	2.87			6-M
12-M	7.09	6.95	6.37	3.66	3.33	3.50	3.58	3.59	3.50	3.42	3.29	3.24	3.22	3.21			12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Nr.	E M E R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	25,886	51,951	87,362	121,753	152,095	182,972	216,152	248,541	279,548	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	256	915	1,703	2,587	3,450	3,793	5,057	5,545	6,294	Grants
II.	Të ardhura tatimore	22,981	46,892	76,564	106,210	133,775	162,128	192,711	223,693	252,354	Tax Revenue
II.1.	Nga Tatimet dhe Doganat	15,669	33,479	56,568	77,104	98,394	120,445	143,774	167,842	190,141	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	9,370	18,365	26,968	36,914	47,151	57,956	69,283	80,196	90,815	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	588	2,243	8,915	10,279	11,778	13,595	15,278	16,682	18,306	Profit Tax
3	Akcizat	1,779	4,359	7,056	10,598	13,904	17,407	21,316	25,948	29,528	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	1,940	4,018	6,141	8,607	11,252	13,510	16,329	19,553	21,967	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	1,643	3,750	6,213	9,019	12,170	15,336	18,402	21,743	25,327	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	349	744	1,275	1,687	2,139	2,641	3,166	3,720	4,198	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	549	1,386	2,512	4,972	5,782	6,732	7,289	8,567	9,440	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	195	388	935	1,921	2,101	2,399	2,589	2,826	3,150	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	14	276	362	628	729	839	842	1,550	1,715	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	340	722	1,215	2,423	2,952	3,494	3,858	4,191	4,575	Local Taxes
III.	Të ardh nga fondet speciale	6,742	12,027	17,485	24,134	29,800	34,952	41,648	47,224	52,772	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	5,600	10,003	14,577	20,077	24,642	29,153	34,804	39,474	44,124	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	1,004	1,716	2,412	3,374	4,071	4,768	5,669	6,364	7,068	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	139	308	496	683	886	1,031	1,175	1,386	1,580	Revenues for property compensation
III.	Të ardhura Jotatimore	2,669	4,144	9,095	12,956	14,870	17,050	18,384	19,363	20,900	Nontax Revenue
1	Tran_Fitimi nga Banka e Shqipërisë				951	951	951	951	951	951	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	2,234	3,321	7,843	9,800	10,884	12,444	13,155	13,620	14,485	Income of budgetary institutions
3	Dividenti				444	449	461	480	518	518	Dividend
4	Tarifat shërbimeve	214	375	476	599	972	1,199	1,355	1,491	1,688	Tariffs on services
5	Të tjera	221	448	776	1,162	1,614	1,995	2,443	2,783	3,258	Other/not allocated
	TOTALI I SHPENZIMEVE	22,913	57,254	91,124	124,060	162,038	195,642	232,577	264,824	298,598	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	21,098	46,431	74,883	102,854	131,985	162,187	193,390	221,743	249,471	Current Expenditures
I.1	Personell	5,474	11,300	17,303	23,115	29,084	35,027	41,185	47,239	53,196	Personnel expenditures
1	Paga	4,764	9,766	14,873	19,905	25,021	30,135	35,464	40,683	45,820	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	710	1,534	2,430	3,210	4,063	4,892	5,721	6,556	7,376	Social insurance contributions
I.2	Interesat	2,984	6,294	8,937	11,822	14,499	17,184	22,058	24,928	27,243	Interest
1	Të Brendshme	2,606	5,354	7,475	9,693	11,965	14,141	16,550	18,903	20,741	Domestic
2	Të Huaja	378	940	1,462	2,129	2,534	3,043	5,508	6,025	6,502	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	882	2,927	6,445	9,491	12,469	17,274	21,133	23,806	27,339	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	53	122	301	363	628	810	985	1,106	1,233	Subsidies
I.6	Shpenzime për fonde speciale	9,875	20,382	31,634	42,800	54,270	65,979	77,917	91,014	102,803	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	7,874	15,911	24,449	32,938	41,522	50,586	59,557	69,088	78,174	Social insurance
2	Sigurime Shëndetësore	2,001	4,471	6,965	9,631	12,517	15,162	18,129	20,871	23,574	Health insurance
3	Fondi I kompensimit të pronarëve			220	231	231	231	231	1,055	1,055	Expenditures for Owners Compensation
I.7	Shpenzime për Buxhetin Vendor	1,127	3,239	5,664	8,722	12,467	16,276	19,066	21,136	23,246	Local budget expenditure
I.8	Shpenzime të tjera	703	2,167	4,599	6,541	8,548	9,637	10,988	12,514	14,411	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	59	116	174	229	280	330	378	426	474	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	655	2,080	3,714	5,506	7,403	7,918	9,219	10,576	12,425	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përdjekurve politike	-11	-29	711	806	865	1,389	1,389	1,512	1,512	Compensation for ex-political prisoners
III	Shpenzime Kapitale	1,584	3,569	8,830	14,215	17,953	20,894	25,457	28,619	34,028	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	102	925	4,568	8,275	10,308	12,528	14,299	15,771	19,124	Domestically financing
2	Financimi Huaj	1,482	2,644	4,262	5,940	7,445	8,366	11,158	12,848	14,904	Foreign financed
IV.	Detyrimet e prapambetura	231	7,254	7,411	7,591	12,120	12,561	13,790	14,462	15,099	Arrears
1	Detyrimet e infrastruktures	211	4,668	4,762	4,886	5,242	5,299	5,554	5,579	5,596	Infrastructure - Arrears
2	Detyrimet tatimore					4,168	4,481	4,517	4,776	5,218	Tax - Arrears
3	Të tjera	20	2,586	2,649	2,705	2,710	2,781	3,719	4,107	4,285	Others
V.	DEFICITI	2,973	-5,303	-3,762	-2,907	-9,943	-12,670	-16,425	-16,283	-19,050	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-2,973	5,303	3,762	2,907	9,943	12,670	16,425	16,283	19,050	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-4,028	-3,708	-5,280	-1,237	1,156	5,333	-26,401	-26,912	-24,316	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	4	28	77	83	242	249	375	636	706	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	4,868	5,441	9,153	12,300	11,716	13,516	20,143	20,417	26,073	Domestic new borrowing (net)
2.1	Nacionale	4,877	5,452	9,072	12,227	11,624	13,426	20,061	20,338	25,978	Other
2.2	Lokale	-9	-11	81	73	92	90	82	79	95	Foreign
3	Të tjera	-8,900	-9,177	-14,510	-13,620	-10,802	-8,432	-46,919	-47,965	-51,095	Other
4	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	-8,020	-6,497	-10,828	-9,941	-6,325	-5,173	-43,836	-45,035	-49,625	Government deposits into the Central Bank
5	Të tjera	-879	-2,678	-3,679	-3,681	-4,478	-3,259	-3,083	-2,927	-1,468	Other
6	Depozita e ISSH dhe ISKSH	2,258	1,219	218	-735	-1,062	-1,456	-1,800	-1,130	405	Deposits of Social and Health insurance
7	Mjete në ruajtje	-25	-210	1,218	-210	-468	-217	-292	-465	-247	Preservation stock
8	Nën-hua	58	118	118	394	442	451	495	663	676	On-Loan Principal
9	Detyrim ndaj ISSH	2,800	2,525	1,982	753	486	-554	-1,795	-2,845	-3,718	Liabilities to SSI
10	Të tjera (detyrime të përkohshme)	-238	-74	-79	102	123	217	289	267	312	Other-Float
V.3	I huaj	1,055	9,011	9,042	4,144	8,787	7,337	42,826	43,195	43,366	Foreign
1	Hua afat-gatë(e marrë)	1,223	1,771	2,840	3,298	3,739	4,038	5,627	7,011	8,980	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nën-hua	406	413	845	981	983	1,059	1,201	1,544	1,979	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	6	-34	-254	96	301	601	541	360	-286	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-839	-1,646	-2,464	-8,170	-9,281	-11,330	-12,268	-13,102	-14,254	Repayments
5	Mblështetje Buxhetore	665	8920	8920	8920	14028	14028	48926	48926	48,926	Budgetary Support

Tab - 5

Tabela e investimeve 2015

Table of investments 2015

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht Aug	Shtator Sep	
Financim i brendshëm	102	925	4,568	8,275	10,508	12,528	14,299	15,771	19,124	Domestic financing
Në %	6.44	25.93	51.73	58.21	58.53	59.96	56.17	55.11	56.20	In %
Financim i huaj	1,482	2,644	4,262	5,940	7,445	8,366	11,158	12,848	14,904	Foreign financing
Në %	93.56	74.07	48.27	41.79	41.47	40.04	43.83	44.89	43.80	In %
Totali	1,584	3,569	8,830	14,215	17,953	20,894	25,457	28,619	34,028	Total
Në %	100	100	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6

TË ARDHURAT DOGANORE 2015 (CUSTOMS REVENUES 2015)

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht Agust	Shtator September	
Taksë doganore	349	744	1,275	1,687	2,255	2,641	3,167	3,720	4,198	Customs Duties
TVSH	5,805	12,386	20,043	27,489	38,183	43,564	52,550	60,795	68,800	V.A.T
